



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT, PYJEVE DHE
ADMINISTRIMIT TE UJRAVE

2007

PLANI I INTEGRUAR I MINISTRISË

Mesazhi i Ministrit

Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, në kuadër të zbatimit të objektivave të qeverisë për vitin 2007 dhe në mbështetje të masave të tjera të planifikuara synon që nëpërmjet këtij programi të integruar t'i përmbushë ato dhe vecanerisht objektivat që lidhen me përmirësimin e cilësisë së mjedisit, mbrojtjes dhe administrimit të pyjeve dhe burimeve ujore. Ministria synon gjithashtu të përmirësojë politikën në fushën e peshkimit si dhe të forcojë masat e kontrollit në qëllim të mbrojtjes dhe administrimit të qëndrueshëm të rezervave peshkore në vendin tone.



Realizimi i objektivave të mesipërme bëhet i mundur nëpërmjet një planifikimi dhe përdorimi efektiv të fondëve buxhetorë të cilat synojnë në përmirësimin e infrastrukurës, rritjen e kapaciteteve planifikuese dhe menaxhuese si dhe në rritjen e investimeve që kanë për qëllim rehabilitimin e sipërfaqeve të demtuara dhe të degraduara si dhe të rritjes së sipërfaqeve me mbjellje të reja në pyje.

Lufter Xhuveli

A handwritten signature in blue ink, which appears to read 'Lufter Xhuveli'. The signature is written in a cursive, flowing style.

Minister i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave

Pasqyra e lëndës

1	Misioni i Ministrisë.....	2
2	Dokumenta strategjike të Ministrisë	3
3	Programet buxhetore të Ministrisë	5
4	Përmbledhje e angazhimeve kryesore në 2007.....	6
5	Plani i Monitorimit të Ministrisë	10
Aneks 1	Projekt-ligjet për tu paraqitur	11
Aneks 2	Rezultate që lidhën me Programin e Qeverisë	12
Aneks 3	Rezultate që lidhën me integrimin Europian	13
Aneks 4	Investimet publike	14
Aneks 5	Projekte të ndihmës së huaj	16

1 Misioni i Ministrisë

Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujerave ka për mision hartimin dhe zbatimin e politikave, strategjive, programeve dhe projekteve të cilat synojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mjedisit dhe të perberësve të tij.

Zhvillimi i sektorit të pyjeve dhe kullotave nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të politikave dhe masave mbështetëse me qëllim të mbrojtjes së pyjeve nga dëmtimet e metejshme si dhe rehabilitimin e sipërfaqeve të dëmtuara dhe të degraduara, është një tjetër objektivi i ministrisë.

Ministria ka për mision gjithashtu hartimin e politikave për administrimin e qëndrueshëm të burimeve ujore dhe rezervave peshkore, duke synuar ruajtjen dhe konsolidimin e metejshëm të këtyre rezervave.

Përafrimi i legjislativës së fushës së mjedisit dhe të standardeve mjedisore në përputhje me direktivat e Bashkimit Europian përbën një objektivi të rëndësishëm në kuadër të procesit të integritimit në Bashkimin Europian dhe NATO.

Politikat e ministrisë janë të orientuara drejt zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit dhe burimeve natyrore si pyjet, ujërat, peshkimi duke synuar në rritjen e nivelit ekonomik dhe të cilësive së jetës së brezave të sotëm dhe atyre që do të vijne.

2 Dokumenta strategjike të Ministrisë

Strategjia ndërsektoriale e mjedisit

Ky dokument i hartuar ne vitin 2006, permban ne vetevete nje sere objektivash dhe drejtime kryesore te politikave qe duhet te zbatohet ministria dhe te iniciativave ligjore qe ajo duhet te ndermarre ne qellim te arritjes se objektivave strategjike afatshkurter, afatmesem dhe afatgjate ne fushen e mjedisit.

Dokumente te tjera strategjike te Ministrise

Strategjia per zhvillimin e sektorit te pyjeve dhe kullotave

Ky dokument percakton drejtimet kryesore dhe masat qe duhen ndermarr ne qellim te ndalimit te prerjeve te paligjshme ne pyje, mbrojtjes se siperfaqeve pyjore nga erozioni dhe administrimit te zjarreve si dhe permiresimit dhe rehabilitimit te siperfaqeve pyjore te demtuara dhe te degraduara. Strategjia parashikon dhe nje sere masash me karakter ligjor.

Plani kombetar i veprimit per mbrojtjen e biodiversitetit

Ky eshte nje dukument i rendesishem mbi bazen e te cilit jane parashikuar dhe ndermarr nje sere masash per permiresimin e kuadrit ligjor per mbrojtjen e biodiversitetit. Ky plan rivleresohet ne afate kohore te percaktuara me qellim te pasqyrimin ne te, te ndryshimeve te nevojshme.

Plani kombetar i veprimit per heqjen nga perdorimi të ndotesve organike te qendrueshem

Ky plan parashikon masat organizative, ligjore dhe administrative per kontrollin dhe heqjen nga perdorimi te ndotesve organike te qendrueshem.

Strategjia per ligatinat

Ky eshte nje dukument i cili vlereson situaten aktuale te ketyre siperfaqeve qe kane vlera te vecanta te biodiversitetit. Strategjia parashikon nje sere masash ligjore, studimore dhe mbrojtjese ndaj ligatinave ne vendin tone.

Qëllime

Politikat e ketij sektori jane hartuar per te kontribuar ne arritjen e qellimeve te meposhtme afatgjata:

- Zhvillimin dhe rishikimin e strategjive dhe politikave ne fushat e mjedisit qe lidhen me parandalimin e ndotjes se ajrit, ujit dhe tokes. Po ashtu politikat do te orientohen ne mbrojtjen dhe administrimin e qendrueshem te tokes; pyjeve, natyres dhe biodiversitetit.
- Forcimin e kontrollit ne zbatimin e legjislacionit per mjedisin; forcimin e bashkepunimit me struktura te tjera ne nivel lokal; parandalimin e demtimit te mjedisit; minimizimin e rasteve te shkeljes se kerkesave ligjore ne mbrojtje te mjedisit; shmangien e abuzimeve ne shfrytezimin e burimeve natyrore; rritjen e masave per minimizimin e erozionit te tokes.
- Aktivitete dhe masa konkrete per t'u ndermarre ne terma afatshkurter, afatmesem dhe afatgjate, me qellim menaxhimin e kujdesshem te siperfaqeve peshkore. Objektivi

afatshkurter eshte krijimi i nje sistemi bashkemenaxhimi te pershtatshem dhe nje sistemi te besueshem te grumbullimit te te dhenave per permiresimin e licensimit dhe perafrimit te legjislacionit ne fushen e peshkimit. Objektivi afatmesem eshte krijimi i nje sistemi bashkemenaxhimi per nje shfrytezim racional te burimeve peshkore. Objektivi afatgjate eshte krijimi i nje sistemi bashkemenaxhimi te qendrueshem ekonomikisht dhe ekologjikisht dhe me nje rol ne rritje te peshkimit dhe akuakultures ne ekonomine shqiptare.

- Permiresimin e cilesise dhe perdorimin e qendrueshem te burimeve ujore. Forcimin e kontrollit ne shfrytezimin e inerteve lumore me tendence drejt ndalimit te tyre; forcimin e strukturave lokale ose ne nivel te baseneve me qellim mbrojtjen dhe perdorimin e qendrueshem te rezervave ujore; forcimin e bashkepunimit me vendet kufitare me qellim te koordinimit te masave ne perdorimin dhe shfrytezimin e rezervave ujore nderkufitare.
- Ruajtjen dhe manaxhimn e qendrueshem te siperfaqeve pyjore ne qellim te mbrojtjes se tyre nga degradimi i metejshem dhe rritja e siperfaqeve pyjore. Permiresimi i kuadrit ligjor. Ndermarrja e masave afatmesme dhe afat gjata qe kane per qellim reformen ne sektorin e pyjeve dhe transferimin e tyre ne administrim te organeve te qeverisjes vendore.

3 Programet buxhetore të Ministrisë

3.1 PLANIFIKIMI, MENAXHIMI DHE ADMINISTRIMI

Politika e këtij programi konsiston në përmirësimin e kushteve të punës, përmirësimin e direktivave menaxhuese, rishikimin e iniciativave të MMPAU dhe zhvillimin institucional. Zhvillimin e politikave dhe të strategjive të sektoreve të mjedisit. Rritjen e efektivitetit të përdorimit të burimeve natyrore. Rritjen e kapaciteteve menaxhuese për zhvillimin, përgatitjen dhe zbatimin e politikave, hartimin dhe zbatimin e ligjeve në përputhje me standartet e BE-se.

3.2 PROGRAME PER MBROJTJEN E MJEDISIT

Politika e këtij programi konsiston në administrimin e mjedisit në nivel lokal. Detyrat kryesore në këtë fushë programi janë të lidhura me zbatimin e kuadrit ligjor për mjedisin, kontrollin për zbatimin e kushteve të lejeve mjedisore, bashkëpunimin me organet e pushtetit vendor për administrimin dhe mbrojtjen e tij nga ndotja dhe demtimi. Mbrojtja e biodiversitetit (flore dhe faune) si dhe mbrojtja e tokës nga erozioni dhe ndotja janë gjithashtu komponente të rëndësishme të këtij programi.

3.3 MBESHETJE PER PESHKIM

Politika e këtij programi konsiston në një ruajtje efektive, menaxhim dhe zhvillim të burimeve të ujore duke respektuar ekosistemin dhe biodiversitetin me qëllim që peshkimi të përbejë një burim vital ushqimi, punësimi, tregu, argetimi dhe mireqenieje për brezat e tanishëm dhe të ardhshëm. Për këtë qëllim është i rëndësishëm: një sektor peshkimi i qëndrueshëm ekonomikisht, që gjeneron shpërndarje të drejte të përfitimeve prej menaxhimit të qëndrueshëm të ekosistemit dhe siguron arritjen e standarteve të BE.

3.4 ADMINISTRIMI I UJRAVE

Politika e këtij programi konsiston në administrimin e burimeve ujore që është një prioritet e politikës së MMPAU. Rezervat ujore dhe cilesia e tyre, dhe vecanerisht ujërat që përdoren për popullësinë, bujqësinë dhe industrinë janë një element i rëndësishëm për zhvillimin e ekonomisë. Forcimi i kontrollit në aktivitetet që përdorin burimet ujore si dhe inertet e lumëve përben politikën kryesore të ministrisë në mbrojtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të rezervave natyrore ujore.

3.5 ADMINISTRIMI I PYJEVE

Politika e këtij programi konsiston në zhvillimin e qëndrueshëm dhe shumëfunksional të resurseve pyjore dhe kullimore, që nënkupton mirëqeverisjen dhe përdorimin e resurseve në një mënyrë dhe me një ritëm që ruan dhe siguron biodiversitetin, prodhimtarinë, aftësinë ripërteritëse, vitalitetin dhe potencialin e tyre për të përmbushur, për sot dhe të ardhmen, funksionet ekologjike, ekonomike dhe sociale në nivel lokal, kombëtar dhe global.

4 Përmbledhje e angazhimeve kryesore në 2007

Sipas programeve, Ministria do të ofrojë produktet e mëposhtme në 2007. Këto produkte përbejnë Planin e Monitorimit të Ministrisë.

4.1 PLANIFIKIMI, MENAXHIMI DHE ADMINISTRIMI

Objektivat e politikës

- Permiresimi dhe përafrimi i kuadrit ligjor për mjedisin, pyjet, peshkimin dhe ujërat
- Rritja e burimeve për investimet në pyje, zonat e mbrojtura dhe peshkim; rritja e kapaciteteve menaxhuese të mjedisit, pyjeve, ujërave dhe peshkimit; ulja e nivelit të ndotjes së ajrit në zonat urbane dhe industriale
- Rritja e sipërfaqeve të zonave të mbrojtura; transferimi i pyjeve dhe kullotave në përdorim të pushtetit lokal
- Monitorimi i treguesve të mjedisit dhe publikimi i tyre. Botimi i raportit përmbledhës me rezultatet e monitorimit të vitit 2005-2006)
- Forcimi i bashkëpunimit me institucionet qendrore dhe organet e qeverisjes vendore për mbrojtjen dhe administrimin e mjedisit në nivel kombëtar dhe lokal
- Vlerësim i ndikimit në mjedis nga aktivitetet industriale dhe aktivitete të tjera që kanë impakt negativ në mjedis
- Informim i publikut për aktivitete dhe veprimtari që kanë ndikim në mjedis dhe sigurimi i pjesëmarrjes së tyre në vendimarrje

Produktet që do të ofrohen

- Permiresimi dhe përafrimi i kuadrit ligjor për mjedisin, pyjet, peshkimin dhe ujërat (hartimi ose amendimi i 8 ligjeve, 4 VKM dhe 10 akte nënligjore (udhëzime dhe rregullore)
- Rritja e kapaciteteve në nivele qendrore dhe lokale me qëllim të administrimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore (organizimi i kurseve të trenimit me qëllim të fuqizimit të kapaciteteve menaxhuese të mjedisit në nivel lokal)
- Permiresimi i legjislativës për zonat e mbrojtura dhe rritja e sipërfaqeve të zonave të mbrojtura në 40 mijë ha.
- Organizimi i aktiviteteve sensibilizuese në kuadër të ditëve mjedisore kombëtare dhe nderkombëtare (9 aktivitete)
- Rritje e numrit të stacioneve të monitorimit të ajrit në zonat urbane dhe industriale (4 stacione)

4.2 PROGRAME PËR MBROJTJEN E MJEDISIT

Objektivat e politikës

- Forcimi i infrastrukurës duke përmirësuar kushtet e punës dhe pajisje me kompjuter, telefon, faks, internet për ARM-te, me qëllim të rritjes së efektivitetit të kontrollit dhe të rolit të tyre në mbrojtje të mjedisit
- Sigurimi i pajisjeve portative për monitorimin e mjedisit;
- Forcimi i bashkëpunimit me struktura të tjera të kontrollit në ministritë e linjes me qëllim të forcimit të kontrollit për mbrojtjen e mjedisit;
- Bashkëpunimi me donatorët për hartimin dhe zbatimin e projekteve në fushën e mjedisit;

- Ndjekja e procesit të zbatimit të projekteve për rehabilitimin e Hot spotëve mjedisore (Porto Romano, Sharra, Arseniku në Fier, Patos Mariza etj)

Produktet që do të ofrohen

- Raporti i dytë kombëtar për konventën e ndryshimeve klimatike
- Raport për Sekretariatën e Liqenit të Ohrit
- Raporti për menaxhimin e qëndrueshëm të tokës
- Forcimi i sistemit të monitorimit të mjedisit;
- Projekte për mbrojtjen e mjedisit

4.3 MBESHTETJE PËR PESHKIM

Objektivat e politikës

- Mbrojtja dhe menaxhimi i ekosistemit bregdetar dhe ujor; menaxhimi i qëndrueshëm i peshkimit
- Ngritja e strukturave të bashkëmenaxhimit;
- Mbeshtetja me investime dhe ristrukturim i sektorit; zhvillimi i akuakultures
- Zbatimi i ligjit dhe organizimi i tregut të peshkut dhe produkteve të tjera të detit
- Rritje e bashkëpunimit me institucionet qendrore dhe lokale për rritjen e efikasitetit të aktivitetëve të akuakultures dhe të peshkimit

Produktet që do të ofrohen

- Prodhimi i rasateve të koranit mbi 1.2 milion
- Ripopullim i liqejve të prespes me mbi 350 mijë rasate krapi
- Ripopullim i liqejve të Ulzës dhe Fierzës me mbi 300 mijë rasate peshku
- Rriteje dhe fuqizim i aktivitetëve të akuakultures në numër dhe kapacitet
- Monitorimi i vazhdueshëm i aktivitetëve të akuakultures me qëllim të respektimit të kërkesave ligjore dhe mbrojtje të biodiversitetit ujor.
- Mbeshtetje për bashkëmenaxhimin e peshkimit mbi baze komuniteti
- Menaxhimi i projektit të peshkimit dhe ndjekja e projektit të ndërtimit të portit të peshkimit Durrës
- Rritje e investimeve në qendrat e rritjes së rasadeve të peshkut me qëllim të rritjes së kapacitetit prodhues të tyre
- Përmirësim i infrastruktures së inspektoreve të peshkimit (kompjuter, telefon, fax)

4.4 ADMINISTRIMI I UJRAVE

Objektivat e politikës

- Forcimi i kontrollit për zbatimin e legjislativës në fushën e përdorimit të burimeve ujore nëpërmjet pajisjes së tyre me makina, kompjuter, telefon, faks etj. të tre basenëve (Mat, Ishëm, Shkumbin)
- Rritja e numrit të punonjësve për basenët me problematike (Mat, Ishëm, Shkumbin dhe Vjose) me një deri dy specialiste.

Produktet që do të ofrohen

- Administrimi i ujerave ne basenet e lumenjeve
- Forcimi i kontrollit per ndalimin e aktiviteteteve te paligjshme ne basenet e lumenjeve
- Permiresim i ligjit per rezervat e ujit si dhe hartimi i akteve nenligjore ne zbatim te tij
- Forcimi i infrastruktures se agjencive te basenit te ujit (kompjuteri, fax, telefon etj)
- Forcimi i kapaciteteve te stafit te agjencive te baseneve te ujit nepermjet organizimit te kurseve te trenimit
- Vleresimi i aplikimeve per perdorimin e rezervave ujore per qellime te ndryshme dhe rritja e kerkeses per perdorimin e qendrueshem te burimeve ujore
- Vleresimi i studimeve te rezervave te inerteve te baseneve te lumenjeve dhe rezervave te gurit gerqelor me qellim te transferimit te aktiviteteteve nga basenet e lumenjeve
- Organizimi i takimeve me vendet kufitare per perdorimin e ujerave nderkufitare (Maqedoni, Greqi)

4.5 ADMINISTRIMI I PYJEVE

Objektivat e politikës

- Hartimi i planeve te mbareshtimit ne pyje dhe ne kullota (15 ekonomi pyjore). Hartimi i planeve te mbareshtimit te kullotave (4 ekonomi kullosore). Pyllezimi dhe ripyllëzimi i siperfaqeve te demtuara, te djegura e te degraduara. Sistemimi i tokave te eroduara me ane te ndertimit te veprave te ndryshme hidroteknike.
- Shfrytezimi i pyjeve ne mbeshtetje te projekteve te mbareshtimit per plotesimin e nevojave me lende drusore (sipas mundesise vjetore te shfrytezimit).
- Projektimi dhe zbatimi per mirembatjen dhe ndertimin e infrastruktures se nevojshme ne ekonomite pyjore te planifikuara per shfrytezim te pyjeve. Projektimi dhe zbatimi per mirembatjen dhe ndertimin e lerrave per shfrytezimin racional te kullotave. Permiresimi i siperfaqeve kullosore per rritjen e kapacitetit te kullotave. Zhvillimi i aktivitetit te fidanishteve pyjore per prodhimin e fidanave pyjore.

Produktet qe do te ofrohen

- Siperfaqe te rehabilituara pyjore e kullosore
- Forcimi dhe mbeshtetje e pyjeve komunale
- Permiresimi i menaxhimit te mikrobaseneve
- Rritje te siperfaqeve pyjore 420 ha
- Sistemime malore ne pyje dhe kullota ne nje volum punimesh prej 5000 m3
- Investime per mbrotjen nga erozioni ne 1800 ha
- Hartimi i planeve te manaxhimit ne mbi 130 komuna

Tabela Buxheti 2007 sipas programeve dhe llojeve te shpenzimeve, milion Lek

Programet	Pagat dhe kontribute e sigurimeve shoqerore 600, 601	Mallra dhe sherbime 602	Subveconet 603	Te tjera transferte korrente 604, 605	Transferta per buxhetet familiare dhe individet 606	Shpenzime kapitale 230, 231	Total
Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	93	36	0	23	0	8	161
Programe per mbrojtjen e mjedisit	21	2	0	11	0	260	295
Mbeshtetje per peshkim	35	20	0	0	40	148	243
Administrimi i ujrave	13	0	0	0	0	0	13
Administrimi i pyjeve	476	142	0	14	0	504	1 137
Total	640	201	0	48	40	921	1 851

5 Plani i Monitorimit të Ministrisë

Treguesit	Njësia	Objektivi
Program menaxhim, administrim		
Permiresimi dhe perafrimi i kuadrit ligjor per mjedisin, pyjet, peshkimin dhe ujerat	Nr	22 akte
Rritje e burimeve per investimet ne mjedis, pyje dhe peshkim ne raport me vitin 2006	%	1.13
Rritje te kapaciteteve menaxhuese te mjedisit, pyjeve, ujerave dhe peshkimit nepermjet takimeve trenuese, informuese dhe sensibilizuese	Nr	4
Rritje e numerit te stacioneve te monitorimit te ajrit	Nr	5
Organizimi i aktiviteteve sensibilizuese ne kuader te diteve mjedisare kombetare dhe nderkombetare (9 aktivitete)	Nr	9
Programe per mbrojtjen e mjedisit		
Rritje e siperfaqes se zonave te mbrojtura	ha	40 000
Raporti i dyte kombetar per konventen e ndryshimeve klimatike	Vol.II	Botim i raportit
Forcimi i sistemit te monitorimit te mjedisit dhe rritja e numerit te stacioneve te monitorimit	Nr	4
Hartimi i raportit kombetare per mbrojtjen e tokes	Nr	1
Raportim vjetor i aktivitetit te sekretariatit te liqenit te Ohrit	Nr	1
Permiresim i infrastruktures se inspektoreve te mjedisit (kompjuter, fax, telefon)	Cop	6
Mbeshtetje per peshkim		
Prodhimi i rasateve te koranit	Cop	1 200 000
Prodhimi i rasateve te krapit	Cop	600 000
Ripopullim i liqejve te Prespes me rasate krapit	Cop	350 000
Ripopullim i liqejve te Ulzes dhe Fierzes me rasate peshku	Cop	300 000
Permiresim i infrastruktures se inspektoreve te peshkimit me kompjuter, fax, telefon	Cop	12
Administrimi i pyjeve		
Hartimi i planeve te menaxhimit te pyjeve komunale	Komuna	130
Sistemime malore ne pyje	m ³	5000
Masa per mbrojtjen nga erozioni	ha	1800
Shtimi i siperfaqeve pyjore	ha	420
Administrimi i ujerave		
Forcimi i kontrollit nepermjet programeve te rregullata ne 6 basenet e ujit	Nr	Periodik
Permbledhje e studimeve mbi rezervat e baseneve te lumejve	Nr.	1
Organizimi i takimeve me shtet fqinje per rezervat e ujit ne kontekstin nderkufitar (Greqi, Maqedoni)	Nr.	2
Fuqizim i kapaciteteve te agjencive te baseneve te ujit (kompjuter, fax, telefon)	Cop	6

Aneks 1 Projekt-ligjet për tu paraqitur

Nr	PROJEKTAKTE	OBJEKTI DHE QELIMI I PROJEKTAKTIT	AFATI
1.	Amendim i ligjit per pyjet	Ne kushtet e reja te organizimit te sherbimit pyjor dhe te problematikes se dale gjate periudhes se zbatimit te ligjit behen te nevojshme disa ndryshime ne ligjin aktual	Prill
2.	Ligji per administrimin mjedisor te zhurmave	Eshte ligj i ri, hartimi i te cilit behet ne perputhje me direktivat e BE-se	Prill
3.	Amendim i ligjit per mbrojtjen e Mjedisit	Amendime qe lidhen me permiresimin dhe lehtesimin e procedurave te licensimit dhe perafrimin e metejshem te tij ne raport me direktivat e BE-se	Nentor
4.	Amendim i ligjit te zonave te mbrojtura.	Plotesimi i disa boshleqeve qe jane vene re gjate zbatimit te ligjit per zonat e mbrojtura te aprovuar ne 2002 dhe ceshtje qe lidhen me habitatet.	Shtator
5.	Amendim i ligjit per rezervat e ujit	Amendimet lidhen me permiresimin e procedurave ligjore per perdorimin e ujit te pjshem.	Nentor
6.	Ligji per mbrojtjen nga tregjetia nderkombetare e llojeve te rrezikuara te faunes dhe flores se eger.	Detyrim ligjor si anetare te Konventes per Tregtine Nderkombetare te Llojeve te Rrezikuara te faunes dhe flores se eger (CITES).	Tetor
7.	Amendim i ligjit per mbrojtjen dhe zhvillimin e bimeve mjeksore natyrore	Amendimet lidhen me perforcimin e masave ligjore per zhvillimin e bimeve mjeksore natyrore.	Nentor
8.	Ligji per ratifikimin e marrveshjes per aderimin ne ICCAT	Ligji parashikon ratifikimin e protokollit per mbrojtjen e sspecies se peshkut ton.	Nentor
9.	VKM per uniformen e policise Pyjore	VKM-ja parashikon kerkersat ligjore per uniformat e policise pyjore	Shkurt
10.	VKM per listen e mbetjeve qe lejohen per import per qellim perdorimi, perpunimi dhe riciklimi,	Eshte miratuar VKM-ja per listen e mbetjeve qe ndalohen dhe mbetet miratimi i listes per mbetjet qe lejohen.	Nentor
11.	VKM per cilesine e Karburanteve	VKM-ja parashikon disa kerkesa standart te karburanteve.	Prill
12.	VKM per Shpalljen zone e mbrojtur te zones Bize-Martanesh	VKM-ja parashikon hartimin dhe miratimin e zones se Bize Martaneshit zone e mbrojtur.	shkurt
13.	VKM, per zgjerimin e kufijve te parkut kombetar te Divjake- karavasta	VKM-ja parashikon studimin dhe pergatitjen e VKM-se perkatese per zgjerimin e kufijve te parkut kombetar te Divjakes	Nentor
14.	VKM , per krijimin e keshillit te politikave pyjore	Akti eshte ne zbatim te ligjit per Pyjet dhe Kullotat.	Nentor
15.	VKM per tarifat e perdorimit te kullotave.	Akti eshte parishkuar te dale pas miratimit te ligjit per kullotat	Nentor
16.	Rregullore per miratimin e procedurave dhe afateve per hartimin e planeve Rajonale te Administrimit te Mbetjeve te Ngurta	Akti eshte ne zbatim te ligjit per Mbetjet	Nentor
17.	Rregullore per miratimin e procedurave dhe afateve per hartimin e planeve Lokale te Administrimit te Mbetjeve te Ngurta	Akti eshte ne zbatim te ligjit per Mbetjet	Nentor
18.	Miratim te Vendimeve te Keshillit kombetar te Ujerave KKU	Vendime qe merren ne mbledhjen e KKU-se	Nentor
19.	Miratim te Vendimeve te Keshillit kombetar te Ujerave KKU	Vendime qe merren ne mbledhjen e KKU-se	Nentor
20.	Permiresim i rregullores se per licensimin dhe kontrollin e peshkimit	Permiresime qe lidhen mereformen rregullatore dhe perafrimin e saje me rreguloren e BE-se	Nentor
21.	Amendimi dhe permiresimi i 9 rregulloreve dhe udhezimeve ne kuader te reformes rregullatore	Permiresimet e akteve qe rregullojne procedurat e licensimit dhe per pajisjen me leje qe jepern nga Minsitria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujerave	Prill- Qershor

Aneks 2 Rezultate që lidhën me Programin e Qeverisë

Objektivat kryesore për vitin 2007 janë si më poshtë:

- Rritja e shkallës së informimit të publikut nepermjet shërbimit on-line
- Rritje e shkallës së bashkëpunimit me organet e pushtetit vendor për administrimin dhe mbrojtjen e mjedisit, pyjeve, peshkimit dhe baseneve të lumëve
- Bashkëpunimi me ministrinë e linjës për kontrollin e cilësisë së karburanteve me qëllim të përmirësimit të cilësisë së ajrit në zonat urbane
- Ulja e shkallës së ndotjes së ajrit në zonat urbane me tendencë të arritjes së standardeve të BE-së
- Rehabilitimi i zonave të nxeta dhe shmangia e rreziqeve për familjet që banojnë në zonat rreth tyre
- Ndalimi i aktiviteteve në zonat me nivel të lartë erozioni, basenet e lumëve etj
- Adaptimi i masave ekonomike dhe fiskale për të mbështetur dhe nxitur aktivitetet ekonomike miqësore me mjedisin dhe instrumenta të teknologjive të pastra
- Trasferimi dhe decentralizimi pyjeve dhe kullotave në përdorim të organeve të qeverisjes vendore
- Forcimi i masave për mbrojtjen e faunës dhe ndalimit të gjuetisë së paligjshme
- Dyfishimi i sipërfaqes së zonave të mbrojtura për periudhën 4 vjeçare
- Forcimi i masave për ndalimin e peshkimit të paligjshëm dhe marrja e masave për ripopullimin e sipërfaqeve peshkore
- Përmirësimi i procedurave ligjore për parandalimin e rasteve të demtimit të mjedisit
- Forcimi i masave për ndalimin e shfrytëzimit jashtë kërkesave ligjore të baseneve të lumëve dhe të demtimit të rezervave ujore
- Edukimi i publikut për administrim të qëndrueshëm të mjedisit

Aneks 3 Rezultate që lidhën me integrimin European

Objektivat kryesore për vitin 2007 janë si më poshtë:

- Ndergjegjesimi i publikut me qëllim të përdorimit të qëndrueshëm të mjedisit
- Krijimi dhe forcimi i strukturave për administrimin e mjedisit në nivel qendror dhe lokal
- Bashkëpunimi me publikun në procesin e vendimarrjes
- Informimi, në kuadër të zbatueshmërisë së Konventës së Arhus, përfshirja në proces të publikut deri në vendimarrje
- Zbatimi i metodologjisë "Për vlerësimin strategjik mjedisor dhe vlerësimin e ndikimit në mjedis", për projekte të rëndësishme
- Identifikimi i çështjeve më të rëndësishme mjedisore dhe hartimi i politikave për zbatimin e tyre
- Zbatueshmëria në mënyrën e duhur të projekteve me ndikim në mjedis nëpërmjet zbatimit të metodologjisë
- Përmirësimi dhe përafrimi i kuadrit ligjor për mjedisin, pyjet, ujërat dhe peshkimin
- Forcimi i strukturave për kontrollin e zbatueshmërisë së ligjit për mbrojtjen e mjedisit, pyjeve, ujërave dhe peshkimit
- Forcimi i bashkëpunimit në kontekstin nderkufitar për mbrojtjen e pyjeve, mjedisit dhe ujërave nderkufitare

Aneks 4 Investimet publike

Emërtimi i projektit	Kosto (në milion lekë)
Programe per mbrojtjen e mjedisit	
Menaxhimi integruar liqenit te Prespes	4
Raporti i dyte kombetar per konventen e ndryshimeve klimatike	4
Panelet diellore	2
Mbeshtetje per ECAT-Tiranan	1
Sekretariati liqenit te Ohrit, Pogradec	2
Te tjera - Programet per mbrojtjen e mjedisit	19
Punime rehabilituese ne Ballsh	2
Eliminimi arsenikut Fier, Faza II	19
Projekt ozoni - Rikuperim dhe riciklim	2
Mbeshtetje per peshkim	
Kosto lokale - Projekti i zhvillimit te peshkimit	18
TVSH - Projekti i zhvillimit te peshkimit	10
Administrimi i pyjeve	
Makineri pajisje	15
Ndertim rikonstruksione	13
Zonat e mbrojtura	21
Kosto lokale - Projekti i zhvillimit te burimeve natyrore	33
TVSH - Projekti i zhvillimit te burimeve natyrore	31
Shpenzime nga te ardhurat e veta (shiko tabelen e poshte)	218

Dshp e rretheve	Pyllezime	Zevendesime	Sherbime kulturore	Punime permiresimi pyjore	Mirembajtje rruge	Sistemime malore	Punime zonat mbrojtura	Permiresim kullote	Riparim lera-cezma	Fidanishte	Ndertim-rikonstrukcion-pajisje	Totali, Ardhura	Totali, Buxheti (sistemime malore)	Totali Ardhura dhe buxheti
Berat	2500	100	300	1500	0	300	1500	0	1000	0	300	7500	1500	9000
Bulqize	4700	0	0	1000	200	1400	0	700	0	0	100	8100	2000	10100
Delvine	0	0	0	500	0	500	800	500	1000	0	200	3500	1300	4800
Devoll	0	0	0	700	0	400	800	0	0	1500	200	3600	900	4500
Diber	1600	100	100	1000	0	500	1000	1000	0	0	100	5400	1300	6700
Durrës	0	0	0	1900	0	0	300	0	0	0	100	2300	0	2300
Elbasan	2500	100	250	700	100	100	0	500	500	0	200	4950	1500	6450
Fier	2100	200	250	800	0	0	700	0	0	0	100	4150	0	4150
Gramsh	1300	100	100	500	300	300	0	0	1500	0	100	4200	1400	5600
Gjirokaster	3000	0	0	500	0	800	600	700	3500	0	100	9200	1800	11000
Has	0	0	0	1000	0	500	0	500	0	0	200	2200	0	2200
Kavaje	0	50	100	1400	300	0	1000	0	0	0	200	3050	0	3050
Kolonje	0	0	0	600	0	300	600	500	0	0	300	2300	1500	3800
Korce	3500	300	250	2000	400	400	900	500	1000	0	600	9850	3000	12850
Kruje	3000	300	350	400	0	500	500	0	0	0	700	5750	1400	7150
Kucove	1000	200	200	300	0	0	0	0	0	0	200	1900	0	1900
Kukes	3500	300	300	1000	0	300	0	600	0	0	300	6300	1900	8200
Lac	2000	100	200	650	0	0	400	0	0	0	200	3550	1600	5150
Lezhe	1200	100	100	1100	0	500	800	0	0	0	500	4300	2200	6500
Librazhd	0	0	0	600	600	600	700	1000	1000	0	300	4800	0	4800
Lushnje	4000	300	400	500	400	0	1500	0	0	1600	600	9300	0	9300
M. Madhe	1200	0	150	2200	300	300	0	0	0	0	300	4450	2500	6950
Mallakaster	1000	0	0	400	0	0	0	0	0	0	200	1600	0	1600
Mat	3000	0	200	2600	600	600	0	300	500	0	600	8400	3000	11400
Mirdite	4000	0	250	2500	600	500	500	0	0	0	600	8950	3000	11950
Peqin	2000	0	100	300	0	0	0	0	0	0	200	2600	0	2600
Permet	0	0	200	300	0	0	1000	500	1500	0	400	3900	0	3900
Pogradec	2000	0	200	800	400	400	600	0	1100	0	100	5600	2000	7600
Puke	2100	0	0	3000	0	0	0	0	0	2200	100	7400	1500	8900
Sarande	0	0	0	500	0	0	0	1500	2400	0	100	4500	1500	6000
Skrapar	1500	0	0	400	0	0	400	500	700	0	100	3600	1500	5100
Shkoder	5500	300	700	2100	800	1600	700	0	0	0	200	11900	3000	14900
Tepelene	2000	0	0	700	300	300	0	1500	2600	0	100	7500	2300	9800
Tirane	1200	0	200	400	0	0	2300	0	500	0	2200	6800	1800	8600
Tropoje	1000	0	0	700	0	0	700	0	0	0	300	2700	0	2700
Vlore	4100	200	400	2000	0	0	1000	1000	2300	0	500	11500	3000	14500
Rezerve	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	20000	20000	0	20000
Totali	66500	2750	5300	37550	5300	11100	19300	11800	21100	5300	31600	217600	48400	266000

Aneks 5 Projekte të ndihmës së huaj

Emri i projektit	Donatori	Kosto totale (million Leke)	Data e mbarimit
Programe per mbrojtjen e mjedisit			
Punimerehabilituese ne rafinerin e naftes ne Ballsh, Faza II	CARDS 2006	150	2009
Ndertimi i landfillit per mbetjet e rrezikshme	CARDS 2006	350	2009
Eliminimi i arsenikut ne Fier, Faza II	CARDS 2006	97	2008
Menaxhimi i pellgut ujembledhes i lumit Drin	GEF	334	2012
Menaxhimi i integruar i ekosistemit te basenit te liqenit te Prespes	GEF/UNDP	132	2010
Projekti i PoPs-eve	GEF/UNDP	38	2007
Projekti i zhvillimit te burimeve natyrore	IDA	910	2011
Projekti i zhvillimit te burimeve natyrore	GEF/SIDA	102	2011
Menaxhimi i mbetjeve te ngurta ne Korce	SIDA	150	2008
Projekti i ozonit - Forcimi institucional	UNEP	1586	2009
Projekti I ozonit - Rikuperimi dhe riciklimi	UNIDO	13	2007
Projekti i ozonit - Monitorimi dhe kontrolli	UNIDO	8	2009
Ndryshimet klimatike - Komunikimi i dyte kombetar	GEF/UNDP	41	2008
Transformimi i tregut per perdorimin e paneleve diellore	GEF/UNDP	35	2007
Mbeshtetje per peshkim			
Projekti zhvillimit te peshkimit	Banka Boterore	794	2007
Projekti per portin e ri te peshkimit ne Durres	Banka Islamike	1166	2010

